

Nënkryetari i Komunës për Komunitete

2021
janar-tetor

Nënkryetari i Komunës për Komunitete (NKK) është mekanizëm mbrojtës në nivel lokal që është i detyrueshëm në komunat ku komunitetet joshumicë përbëjnë të paktën dhjetë për qind të popullsisë së komunës. Me vendim të kuvendit të komunës, mund të krijohet edhe në komuna ku komunitetet joshumicë nuk e arrijnë pragun prej dhjetë për qind. Kandidatin për NKK e propozon kryetari dhe e miraton kuvendi i komunës. NKK është i mandatuar për t'i dhënë këshilla dhe udhëzime kryetarit të komunës për çështje që lidhen me komunitetet dhe i njëjti duhet t'i përfaqësojë të gjitha komunitetet që banojnë në komunë.

Dokumentet kryesore

- Ligji për vetëqeverisjen lokale (nr. 03/L-040, 2008);
- Udhëzimi administrativ (MAPL) nr. 01/2014 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna;*
- Termat e referencës për NKK

* Udhëzimi administrativ (MAPL) nr. 01/2014 u shfuqizua me hyrjen në fuqi të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna më 21 shtator 2020.

Themelimi

Pozita e NKKK është krijuar në 14 komuna.

Pozitat e krijuara të NKKK *


Dragash	Mamushë
Ferizaj	Novobërdë
Fushë Kosovë	Obiliq
Gjilan	Prizren
Kamenicë	Shtërpcë
Klllokot	Zubin Potok ¹
Lipjan	Zveçan ¹

¹ Mungesa e të dhënave nga regjistrimi i popullsisë krijon paqartësi për sa i përket themelimit të kësaj pozite për këto komuna. Prandaj, për qëllime të kësaj analize janë përdorur vlerësimet e numrit të popullsisë në Profilët e komunave të Kosovës të përpiluara nga Misioni i OSBE-së në vitin 2018. (Gjenden tek <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/municipal-profiles>)

* **Me shkronja të zeza të theksuara** janë të paraqitura komunat ku NKK-të janë të detyrueshëm sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullsisë.


Shënim. Në Graçanicë dhe Mitrovicë Veriore pozita e NKK ishte boshë gjatë periudhës së raportimit. Prandaj, këto komuna nuk janë pasqyruar në diagrame dhe tabelën e performancës.

Qasja në burime financiare*




Përbërja gjinore dhe përfaqësimi i komuniteteve

Përfaqësimi i komuniteteve



Përbërja gjinore



* Tri komunat me NKKK gra janë Klllokoti, Mamusha dhe Prizreni.

Performanca në vitin 2021


Treguesit e përzgjedhur të performancës

Numri i NKK-ve që i kanë realizuar aktivitetet kryesore dhe detyrat themelore të përcaktuara me kornizën ligjore dhe të politikave, bazuar në monitorimin e rregullt dhe shqyrtimet periodike nga ekipet në terren të Misionit të OSBE-së në Kosovë, si dhe raportet e komunave.


Shënim: krahasimi është bërë ndërmjet 12 muajve të vitit 2020 dhe 10 muajve të vitit 2021, si rrjedhojë e zgjedhjeve lokale të mbajtura në tetor 2021.

1 – Këshillat, udhëzimet dhe mbikëqyrja

Ofrimi i këshillave dhe udhëzimeve për kryetarin lidhur me çështje që kanë të bëjnë me komunitetet




Konsultimi me kryetarin e komunës lidhur me nevojat dhe interesat e komuniteteve gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit




2 – Buxheti

Sigurimi i ndarjes së mjeteve të mjaftueshme për mekanizmat komunalë për çështje në interes të të drejtave të komuniteteve




3 – Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve

Angazhimi në aktivitete të promovimit të dialogut ndërmjet komuniteteve




4 – Bashkëpunimi

Veprimi si pikë kontakti për zbatimin e rekomandimeve të KK-së nga ana e kuvendit të komunës




Promovimi i përfshirjes së drejtpërdrejtë të komuniteteve në aktivitetet e kuvendit të komunës



5 – Raportimi

Raportimi tek kryetari çdo gjashtë muaj



Performanca e gjithëmbarshme

Vlerësimi i performancës së NKK-ve bazohet në rezultatin total të përbushjes së treguesve të performancës, që janë pasqyrim i aktiviteteve kryesore dhe detyrave themelore të parapara më kornizën përkatëse ligjore dhe të politikave. Performanca është vlerësuar si e "E lartë" kur rezultati total është mbi 66 për qind, "Mesatare" kur varion mes 66 dhe 33 për qind, dhe "E ulët" kur është nën 33 për qind.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ofron mbështetje për pjesëmarrjen e shtuar të komuniteteve në proceset e vendimmarrjes dhe të qeverisjes, si edhe në institucione. Në suazat e këtyre përpjekjeve, Misioni i OSBE-së në Kosovë e monitoron rregullisht punën e mekanizmave komunalë për mbrojtjen e komuniteteve. Këto fletushka informuese kanë si qëllim që institucioneve përkatëse t'u ofrojnë tregues që mund t'u ndihmojnë në identifikimin e mangësisë dhe përmirësimin e pajtueshmërisë.

	Këshillat, udhëzimet dhe mbikëqyrja	Buxheti	Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve	Bashkëpunimi	Raportimi	PERFORMANCA E GJITHËMBARSHME
Dragash	E lartë	E lartë	Mesatare	Mesatare	E lartë	85%
Fushë Kosovë	E lartë	E lartë	Mesatare	E lartë	E lartë	89%
Kllokot	E lartë	E ulët	Mesatare	E lartë	E ulët	48%
Novobërdë	E lartë	E ulët	Mesatare	Mesatare	E lartë	67%
Prizren	E lartë	E lartë	Mesatare	Mesatare	E lartë	85%
Shtërpçë	E lartë	E lartë	Mesatare	Mesatare	E ulët	62%
Ferizaj	E lartë	E lartë	Mesatare	E lartë	E lartë	86%
Gjilan	E lartë	E ulët	E ulët	E lartë	E lartë	64%
Kamenicë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	98%
Lipjan	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	91%
Mamushë	Mesatare	E ulët	E ulët	E ulët	E ulët	1
Obiliq	Mesatare	E lartë	E ulët	Mesatare	E ulët	41%
Zubin Potok	E lartë	E ulët	Mesatare	E ulët	E lartë	60%
Zvečan	E lartë	E ulët	Mesatare	E ulët	E ulët	38%
PERFORMANCË MESATARE 2021	88%	59%	55%	59%	68%	66%
PERFORMANCË MESATARE 2020	93%	66%	64%	58%	66%	70%